## E nëse mbeturinat janë shumë, apo janë voluminoze?




**QENDRA E GRUMBULLIMIT (tanimë Stacion Ekologjik)**

Rruga Circonvallazione Ovest, 32-/34 (di fianco al cimitero)
Të martë:7.00 – 13.00
Të enjte: 14.30 – 17.30
Të shtunë: 8.30 – 13.00 e 14.30 - 16.30

Shërbimi është falas dhe në dispozicion të të gjithë qytetarëve. Mbeturinat duhet të dorëzohen me mjetet lëvizëse tuaja, të ndara në varësi të llojit dhe të reduktuara në dimension, sa më shumë që të jetë e mundur. Kur shkohet për herë të parë, duhet të paraqitet fletëpagesa e mbeturinave ose një dokument i vlefshëm.
**Mund të dorëzohen:** letra dhe ambalazhe kartoni (të palosura në mënyrë që të zënë sa më pak vend) plastikë, polistirol, qelq, kanaçe llamarine, mbajtëse metalike, materiale organike, dru (krevatë, mobilje ose pjesë mobiljesh, mbetje drusore), mbetjet nga kositja e barit, mbetjet nga krasitja e kopshtit, trungje të vogla (pjesë jo më të gjata se 2 m) mbetje inerte dhe sanitare, mbetje voluminose (rafte, rrjeta krevati, lavatrice, kaloriferë, dyshekë, divane) goma makinash pa disk, RAEE e RUP, pajisje elektroshtëpiake të vogla e të mëdha.

**Tërheqje falas e mbetjeve voluminoze:** nëse nuk ke mundësi t'i sjellësh në Qendrën e Grumbullimit, telefonoji Shërbimit të Klientëve Hera 800.900.000 dhe prenoto tërheqjen falas në shtëpi.

# Bën ndryshimin!

## Grumbullimi DERË MË DERË i mbeturinave

Nga 6 maji 2013 hyn në funksionim shërbimi i grumbullimit derë më derë i mbeturinave.
Kjo do të thotë që nuk do të ketë më kazanë mbeturinash nëpër rrugë përveç kazanëve në formë kambane dhe kazanëve mbajtës të veshjeve.
Grumbullimi i letrës, plastikës, mbetjeve organike, barishteve e mbetjeve nga krasitjet,
dhe mbetjeve të padiferencueshme bëhet në shtëpi dhe për këtë qytetarët duhet të
zbatojnë disa rregulla të thjeshta:

- të reduktojnë volumin e ambalazhit në mënyrë që të zërë pak vend;
- të mos lënë mbeturina përdhe, nëse nuk parashikohet nga shërbimi specifik;
- të mos hedhin në kosha mbeturina të ndryshme nga ato që kërkohen;
- të përdorin vetëm thasë/kosha përkatës (që tërhiqen pranë Qendrës së Grumbullimit);
- t'i vendosin përpara shtëpisë nga ora 20 deri 22 në ditët e caktuara në kalendar.

Shërbimi parashikon edhe **tërheqjen falas në shtëpi të mbetjeve voluminoze dhe pajisjeve të mëdhaja elektroshtëpiake** pasi më parë të jetë bërë prenotimi telefonik.
Për të kufizuar veprimet jo korrekte dhe për të tuteluar qytetarët, ju informojmë **që është i detyrueshëm diferencimi i mbetjeve** në përputhje me kushtet e sistemit të grumbullimit duke respektuar oraret e vendosjes përpara shtëpisë.
**Për shkelësit e rregullave parashikohen sanksione administrative.**

INFORMACIONE MBI MBETJET
**HERA -** Shërbimi i klientëve
nga numër fiks: N. jeshil (pa pagesë) 800.999.500
nga celulari: thirrje me pagesë 199.199.500
nga e hëna në të premte ora 8-18 të shtunën ora 8-13
www.gruppohera.it

**Komuna e Castello d'Argile**
**Zyra Teknike:** tel. 051 6868852
**Zyra e Marrëdhënieve me Publikun:** tel. 051 6868813

# SI, ÇFARË DHE KUR

## Grumbullimi derë më derë për të gjithë përdoruesit shtëpiakë (banues në zona rurale, qendra të banuara, zona industriale)

| MBETJE | LLOJI | KU dhe KUR |
|---|---|---|
| TË PADIFERENCUESHME | **PO**: gjithçka që nuk është e diferencueshme, gomë, sfungjer, kocka, copëra qeramike, bishta cigaresh, shtrojë për kafshët, rrecka, varëse rrobash, dru i trajtuar apo i lyer, pelena njëpërdorimëshe, peceta thithëse higjenike, garza, leukoplaste, lugë, pirunj, e thika plastike, letër kimike, letër me vaj ose e ndotur, lojëra jo elektronike, filtra dhe thasë për fshesa korenti, CD/DVD/VHS dhe kutitë mbrojtëse.<br>**JO:** mbetje të diferencueshme, dhe gjithçka që mund të çohet në Qendrën e Grumbullimit, mbetje të rrezikshme, mbetje voluminoze, mbetje nga ndërtimet dhe shembjet (inerte, suva etj) substanca të lëngshme, materiale të ndezura.<br>**SI:** futini në thasë ose mbështjellëse të mbyllura mirë. | BIDONI NGJYRË GRI **të mërkurën** |
| VAJRAT VEGJETALË | **SI:** mblidhini të ndarë sipas llojit në çfarëdo tipi mbajtëseje (shisheje etj) | KAZANËT E RRUGËS ose QENDRA E GRUMBULLIMIT |
| RAEE e RUP | RAEE mbetje nga pajisje elektrike dhe elektronike ventilatorë, hekura për hekurosje, thekëse buke, friteza, tharëse flokësh, notebook, celularë, orë me zile, llampa etj.<br>RUP (mbetje urbane të rrezikshme) bojëra, kollë, lëndë tretëse, pila, bateri, pesticide, vajëra minerale, temometra me mërkur. | QENDRA E GRUMBULLIMIT |
| PELENA NJËPËRDORIMË SHE ILAÇE VESHJE TË PËRDORURA | pelenat njëpërdorimëshe janë mbetje të padiferencueshme por mund të hidhen edhe në bidonat e rrugës të pajisur me çelës. | KAZANËT E RRUGËS |
| KOSITJE DHE KRASITJE | **PO:** degëza, barishte, lule, gjethe, tallash, copëza druri, shkurre, dherishte, lëvore trungjesh, hi drunjsh i fikur. Nëse sasia është e konsiderueshme mund të çohen pranë Qendrës së Grumbullimit (Stacioni ekologjik).<br>**JO:** mbeturinat e kuzhinës, mbetje nga ushqime jo vegjetale, ushqime të lëngshme, bishta cigaresh, shtroje për kafshë dhe mbetje jo organike.<br>**SI:** futini nëpër thasë ose i lidhni e stivoni në vandakë. | THASË JESHILË OSE VANDAKË (frekuenca sipas kalendarit) |
| LETËR DHE KARTON | **PO**: gazeta, revista, libra, fletore, letra ambalazhimi, kartona, kuti këpucësh apo ushqimesh, kuti kartoni detergjentësh për larje, letër fotokopje, ambalazhe, letër e shumëfishuar (lloji tetrapack dhe kuti kartoni për lëngje), letra me pjesë të vogla prej materiali të ndryshëm (zarfe ose kuti kartoni për makarona me pjesë plastike në formë etikete), gota dhe tabaka prej kartoni, kuti kartoni picash pa mbeturina.<br>**JO:** kopertina të plastifikuara, letër me lyrë apo e ndotur me substanca të tjera, letër me vaj, letër kimike për faks, letër autokopjative, (edhe kupon fiskal), letër kopjative, letër për veshje muri, letër furri, gota dhe pjata plastike.<br>.**SI:** shtypi kutitë, hiqi shiritin ngjitës dhe kapëset | THES I KALTËR **të martën** (çdo dy javë) |
| PLASTIKA | **PO:** anbalazhe me simbolet PE, PP, PVC, PET, PS, shishe, shishka, mbajtëse ushqimesh prej plastike ose polistiroli, qese plastike për psonisje, mbështjellëse e hollë plastike dhe qese plastike për ushqimet, rrjeta plastike për fruta dhe perime, kavanozë të vegjël plastike kosi, arka plastike për fruta, pjata dhe gota plastike njëpërdorimëshe pa mbeturina ushqimesh,<br>**JO:** gjithçka që nuk është ambalazh plastik, orendi, lodra, letër e shumëfishuar e llojit tetrapack, CD, DVD, kaseta audio, VHS dhe mbrojtëset, kanaçe për kollë-bojëra-tretësa, çanta, çanta shpine, valixhe, plastikë e fortë (varëse rrobash, orendi shtëpiake, tavlla duhani etj), lugë pirunj, thika, letër varaku (psh. për mbështjellje biskotash etj).<br>**SI:** shpëlaji dhe kulloji mbajtëset e ndotura, shtypi | THES I VERDHË **të martën** (çdo dy javë. Një herë në javë në periudhën e verës) |
| QELQ DHE LLAMARINË | **PO:** mbajtëse (shishe, kavanoza, shishka, damixhanë pa kashtë, gota) kanaçe, kuti llamarine për lëngje dhe ushqime, letër alumini, tapa dhe mbyllëse për kavanozë dhe shishe, mbajtëse bosh ushqimesh apo produktesh për higjenën personale me simbolet FE, ALU, ACC, (deodorante, llakëra, ajkë (pana).<br>**JO:** pasqyra apo kristale, syze, qelq pirex, qeramikë, porcelan, llampa me neon, kavanozë/kanaçe produktesh kimike të rrezikshme (bojëra, tretësa, vaj motorri, benzinë), letër varaku (psh. për biskotat, vezët e pashkës etj).<br>**SI:** zbrazi, kulloji, shtypi | KAZANËT E RRUGËS NË FORMË KAMBANE |
| ORGANIKE | **PO:** mbeturinat vegjetale dhe ushqimore, mbetjet e kafesë ekspres dhe filtrat e çajit, pjata dhe gota prej plastike-bio, letra dore të ndotura, hi i fikur oxhaku, kocka të vogla, guaska molusqesh.<br>**JO:** ushqime të lëngshme, kocka me përmasa të mëdha, bishta cigaresh, shtroje për kafshë, yndyrna dhe vajra, dru i trajtuar apo i lyer ose me dimensione të mëdha, tapa druri, kruajtëse dhëmbësh, mbetje jo organike (pelena njëpërdorimëshe, peceta higjenike thithëse etj).<br>**SI:** vendosini brenda në bidon pasi t'i keni futur në thasë të kompostueshëm | BIDONI NGJYRË GËSHTENJË **të hënë dhe të enjte** (në zonat rurale vetëm të enjte) |